



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1486/6 prot.

Datë 29/07/2022

V E N D I M

Nr.732/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 29.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Naimi 2020” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-31236-05-31-2022, me objekt: “*Prodhim i Lëndës Drusore*”, me fond limit 35.833.333 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Mbetjen të skualifikuar të operatorit ekonomik “PISHA” SHPK, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së këtij operatori ekonomik, pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht: pikat 1.e dhe 1.dh të “*KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 9, pikat 2.1.a dhe 2.1.b të “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pikën 2.2.1.3 ‘*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*’, pikat 2.3.1, 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.6 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit, nuk ka plotësuar saktë preventivin dhe ofertën e dorëzuar në tender, si dhe nuk ka paraqitur në tender grafikun e punimeve.

| | |
|--------------------------------|--|
| Ankimues: | Operatori ekonomik “NAIM 2000” SHPK Adresa: Farkë, Sauk pranë-Restorant “Osma”, Tiranë. |
| Autoriteti Kontraktor: | Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Adresa; Rruga “Liman Kaba”, Parku Olimpik, Tiranë. |
| Subjekte të Interesuar: | Operatori ekonomik “PISHA” SHPK Adresa: Rruga “Labinot Fushë – Elbasan”, km 1, zk.2355, pasuria nr.A, Labinot Fushë, Elbasan. |
| Baza Ligjore: | Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik. |

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.06.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-31236-05-31-2022, me objekt: “Prodhim i Lëndës Drusore”, me fond limit 35.833.333 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Në datën 21.06.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 30.06.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- | | | |
|-------------------|------------|----------------|
| - Naimi 2020 ShPK | 33,691,058 | I skualifikuar |
| - Pisha | 35,704,146 | I skualifikuar |

II.4. Në datën 30.06.2022 operatori ekonomik “Naim 2020” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- *Për përmbushjen e pikës 2.3.1, OE “Naimi 2020” ShPK, ka paraqitur në sistem kontratën me nr. 910/14 prot., datë 05.08.2021 me objekt "Pyllëzim me akacie", të lidhur me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit në cilësinë e AK, shoqëruar me vërtetim realizimi, faturë tatimore, dhe akt-marrje në dorëzim Referuar objektit të kontratës nr. 910/14 datë 05.08.2021, të përcaktuar në nenin 2, pika 2.1 dhe pika 2.2 të saj, arrihet në konkluzionin se kjo kontratë është e tipit “punë” dhe jo e tipit “shërbim”, si kundër është kontrata që synohet të lidhet nga AK nëpërmjet kësaj procedure prokurimi, për të cilën OE “Naimi 2020” ShPK ka ofertuar. Gjithashtu fakti që ndodhemi përballë një kontrate të tipit punë, përcaktohet qartë edhe në certifikatën e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve të datës 23.11.2021, nga përmbajtja e të cilës rezulton se grupi i punës se ngritur nga AK ka marrë në dorëzim zërat e punimeve të realizuara sipas kontratës së sipërcituar dhe nuk ka marrë në dorëzim zëra shërbimesh. Nga shqyrtimi i zërave të preventivit pjesë e kontratës nr. 910/14 datë 05.08.2021, konstatohet se asnjë prej zërave të këtij preventive nuk është i ngjashëm me zërat e preventivit të kontratës objekt prokurimi. - Nisur sa më sipër, OE “Naimi 2020” ShPK nuk përmbushë kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.1 të DST, për shkak se kontrata me nr. 910/14 datë 05.08.2021, e paraqitur për të provuar përvojën e mëparshme nuk është një kontratë e tipi shërbim, sikurse është kontrata që synohet të lidhet nga AK, si dhe asnjë nga zërat e kontratës së paraqitur nga OE “Naimi 2020” ShPK nuk është i ngjashëm me zërat e preventivit të kontratës objekt i këtij prokurimi.”.*

II.5. Në datën 08.07.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 12.07.2022 operatori ekonomik “Naimi 2020” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik me objekt kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Pisha” ShPK.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1486/2 prot datë 13.07.2022.

II.8. Me datë 14.07.2022 dhe më datë 22.07.2022 operatori ekonomik ankimues “Naim 2020” SHPK ka paraqitur informacion shtesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Me shkresën nr. 1096/19 prot, datë 22.07.2022 me objekt: “Informacion”, protokolluar me tonën me nr. 1486/5 prot datë 25.07.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Naimi 2020” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr.162/2020 për prokurimin publik.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Naimi 2020” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se “Për përmbushjen e pikës 2.3.1, OE “Naimi 2020” ShPK, ka paraqitur në sistem kontratën me nr. 910/14 prot., datë 05.08.2021 me objekt “Pyllëzim me akacie”, të lidhur me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit në cilësinë e AK, shoqëruar me vërtetim realizimi, faturë tatimore, dhe akt-marrje në dorëzim Referuar objektit të kontratës nr. 910/14 datë 05.08.2021, të përcaktuar në nenin 2, pika 2.1 dhe pika 2.2 të saj, arrihet në konkluzionin se kjo kontratë është e tipit “punë” dhe jo e tipit “shërbim”, si kundër është kontrata që synohet të lidhet nga AK nëpërmjet kësaj procedure prokurimi, për të cilën OE “Naimi 2020” ShPK ka ofertuar. Gjithashtu fakti që ndodhemi përballë një kontrate të tipit punë, përcaktohet qartë edhe në certifikatën e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve të datës 23.11.2021, nga përmbajtja e të cilës rezulton se grupi i punës se ngritur nga AK ka marrë në dorëzim zërat e punimeve të realizuara sipas kontratës së sipërcituar dhe nuk ka marrë në dorëzim zëra shërbimesh. Nga shqyrtimi i zërave të preventivit pjesë e kontratës nr. 910/14 datë

05.08.2021, konstatohet se asnjë prej zërave të këtij preventive nuk është i ngjashëm me zërat e preventivit të kontratës objekt prokurimi. - Nisur sa më sipër, OE "Naimi 2020" ShPK nuk përmbushë kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.1 të DST, për shkak se kontrata me nr. 910/14 datë 05.08.2021, e paraqitur për të provuar përvojën e mëparshme nuk është një kontratë e tipi shërbim, sikurse është kontrata që synohet të lidhet nga AK, si dhe asnjë nga zërat e kontratës së paraqitur nga OE "Naimi 2020" ShPK nuk është i ngjashëm me zërat e preventivit të kontratës objekt i këtij prokurimi., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3 "Kapaciteti teknik" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasisë e mallrave të furnizuara,

Ose

b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimes Naimi 2020 ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Nr. 910/14 prot., datë 05.08.2021 me objekt "Pyllëzim me akacie", të lidhur midis BOE Naim 2000 ShPK & Diava Consulting ShPK (Naimi 2020 97,108.... % dhe Diava Consulting 2.89...%) dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, me vlerë totale **13,903,220** lekë pa TVSh në cilësinë e AK, shoqëruar me Formular Vlerësimi, faturë tatimore, dhe akt-marrje në dorëzim.
- Faturë tatimore shitje me numër serial: 96646406, datë 14.06.2021, ku shoqëria "NAIM 2020" SHPK i shitur shoqërisë "G.A.C" SHPK punimet si në vijim: "Prerje e pastrim shkurre e ferra; Hapje gropa 50x50x50 cm; F.V fidanë Hartine Akacie Mimoza dhe Panja Mali; Sistemim i dherave në sipërfaqen e mbjellë dhe mbjellje bari", me vlerë 3.000.000 lekë pa-TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi lëshuar nga shoqëria "G.A.C" SHPK.

III.1.3. Neni 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.

III.1.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*
- *Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.1.5. Komisioni gjykon se vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u

përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Referuar sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Naimi 2020" SHPK në përmbushje të kriterit për përvojë të ngjashme, KPP vëren se ky i fundit ka paraqitur Kontratë Nr. 910/14 prot., datë 05.08.2021 me objekt "Pyllëzim me akacie", të lidhur midis BOE Naim 2020 ShPK& Diava Cobsulting ShPK (Naimi 2020 97,108.... % dhe Diava Consulting 2.89...%) dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, me vlerë totale **13,903,220** lekë pa TVSh në cilësinë e AK, shoqëruar me Formular Vlerësimi, faturë tatimore, dhe akt-marrje në dorëzim dhe faturën tatimore të shitjes me numër serial: 96646406, datë 14.06.2021, ku shoqëria "NAIM 2020" SHPK i ka shitur shoqërisë "G.A.C" SHPK punimet si në vijim: "Prerje e pastrim shkurre e ferra; Hapje gropa 50x50x50 cm; F.V fidanë Hartine Akacie Mimoza dhe Panja Mali; Sistemim i dherave në sipërfaqen e mbjellë dhe mbjellje bari", me vlerë 3.000.000 lekë pa-TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi lëshuar nga shoqëria "G.A.C" SHPK.

Referuar kriterit të veçante të kualifikimit rezulton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. KPP referuar vlerës së fondit limit **35.833.333 lekë pa TVSh** gjykon, se vlera e kontratës apo kontratave të ngjashme që duhet të plotësohet nga ankimuesi është në shumën 14,333,333.2 lekë pa TVSh.

KPP vëren, se kontrata Nr. 910/14 prot., datë 05.08.2021 dhe fatura tatimore me numër serial: 96646406, datë 14.06.2021 klasifikohen si shërbime të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit objekt-ankimimi dhe se vlera e tyre në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit nga operatori ekonomik Naimi 2020 ShPK arrin të përmbushë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit në masën prej 40% të fondit. Në këtë kuptim, KPP gjykon se operatori ekonomik "NAIM 2020" SHPK me dokumentacionin e paraqitur provon se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi vlera e kontratës Nr. 910/14 prot., datë 05.08.2021 dhe vlera e faturës tatimore me numër serial: 96646406, datë 14.06.2021 të paraqitura plotësojnë vlerën e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi prej 40% të fondit limit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "NAIM 2020" SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "NAIM 2020" SHPK Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi referuar gjykimit më sipër, gjendja faktike dhe juridike e

operatorit ekonomik "PISHA" SHPK do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 "Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "NAIM 2020" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-31236-05-31-2022, me objekt: "Prodhim i Lëndës Drusore", me fond limit 35.833.333 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "NAIM 2020" SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "NAIM 2020" SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri